



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21648 Prot.

Lezhë, më 18 . 12 . 2025

VENDIM

Nr. 115, Datë 15. 12. 2025

PËR LËNIEN NË FUQI TË TARIFAVE EKZISTUESE TE UJIT TË PIJSHËM

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe perpunimit të ujërave të ndotura", në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.6, datë 15.06.2023 dhe Vendimin e Asamblesë së Aksionerëve nr. 3, date 30.06.2023, për miratimin e planit tarifor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë sh.a. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë AKUM, Bashkia Lezhë, Bashkia Kurbin dhe Bashkia Mirditë, në ligjin Nr.8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe perpunimit të ujërave të ndotura" i ndryshuar, në Vendimin nr.539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjiellës Kanalizime", në shkresën e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë Sha nr. 845 Prot. datë 09.10.2025 "Kërkesë për dhënie mendimi për lënien në fuqi të tarifave ekzistuese të ujit të pijshëm", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Vazhdimin me planin tarifor ekzistues të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë sh.a., në juridiksionin e territorit të Bashkisë Lezhë.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë sh.a dhe Bashkia Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 21648/1 prot
Dt. 28-12-25

K.B

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1249/6 Prot.

Lezhë, më 24.12. 2025

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut, nenin 54, gërma "f" të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; i ndryshuar", ligjin nr.8102, datë 28.3.1996 "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" i ndryshuar VKM nr. 302, datë 11.5.2022 "Për Politikat kombëtare për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimin dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" dhe Vendimin nr. 539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimit ujësjellës-kanalizime" i ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.115, datë 15.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për lënien në fuqi të tarifave egzistuese të ujit të pijshëm".

P R E F E K T I

Taulant MALSHI

